VENDIM
Nr.234, datë 23.3.2011

PËR KRIJIMIN E UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 9, 10, 41, 76 e 77 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Krijimi dhe misioni i Universitetit të Arteve (UART):

1. Krijohet Universiteti i Arteve (UART), si institucion publik i arsimit të lartë, nëpërmjet riorganizimit të Akademisë së Arteve.

2. UART-ja ka për mision:

a) ofrimin e studimeve universitare të ciklit të parë, të dytë dhe të tretë në fushën e artit e të kulturës;

b) zhvillimin e mbrojtjen e dijeve nëpërmjet mësimdhënies dhe veprimtarisë artistike që kryhet brenda e jashtë vendit;

c) formimin e studiuesve të rinj në fushat teorike të vlerësimit të artit e të kulturës;

ç) thellimin e kualifikimit profesional e shkencor të specialistit të lartë në fushën e artit e të kulturës;

d) kryerjen e kërkimeve shkencore për të zhvilluar e tejçuar artin e kulturën;

dh) ndihmesën në rritjen e standardeve të demokracisë e të qytetërimit dhe cilësisë së shoqërisë, si dhe përgatitjen e të rinjve për një shoqëri të tillë.

II. Struktura e UART-së:

1. Në strukturën e UART-së përfshihen njësitë kryesore, si më poshtë vijon:

a) Fakulteti i Muzikës, me këtë përbërje si njësi bazë:

i. Departamentin e kompozicion-muzikologji-dirigjimit;

ii. Departamentin e interpretimit.

b) Fakulteti i Artit Skenik, me këtë përbërje në njësi bazë:

i) Departamentin e aktrimit dhe regjisë së filmit dhe televizionit;

ii) Departamentin e regji-skenografi-koreografi-teori e arteve.

c) Fakulteti i Arteve të Bukura, me këtë përbërje në njësi bazë:

i) Departamentin e pikturës;

ii) Departamentin e skulpturës.

III. Programet e studimeve të UART-së

UART-ja ofron të gjitha programet e studimit në të tria ciklet e studimit që ka ofruar deri tani Akademia e Arteve dhe çdo program tjetër, të miratuar në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

IV. Organet dhe autoritetet drejtuese

1. Organet dhe autoritetet drejtuese të zgjedhura për strukturat e Akademisë së Arteve vazhdojnë mandatet e tyre.

2. Autoritetet drejtuese të UART-së janë:

a) Rektori;

b) Dekanët e fakulteteve;

c) Përgjegjësit e departamenteve.

3. Rektori emërohet sipas pikës 2 të nenit 23 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

4. Autoritetet drejtuese të zgjedhura të strukturave ekzistuese funksionojnë në përputhje me ligjin nr.9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

si edhe me statutin e UART-së.

5. Autoritetet e tjera drejtuese emërohen dhe funksionojnë në përputhje me nenin 23 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

V. Organika dhe financimi

1. Organika e UART-së përmban numrin e punonjësve të njësive, që integrohen në të dhe që përfshihen në numrin total të punonjësve, që janë miratuar për Akademinë e Arteve.

2. Financimi i UART-së, për vitin 2011, bëhet nga:

a) buxheti i planifikuar për Akademinë e Arteve;

b) burime të tjera të ligjshme.

3. Universiteti i Arteve ruan të drejtën mbi të gjitha asetet dhe fondet buxhetore që zotëron dhe disponon ish-Akademia e Arteve.

4. Universiteti i Arteve ka selinë në Tiranë, në godinën e ish-Akademisë së Arteve.

5. Universiteti i Arteve e fillon veprimtarinë për vitin akademik 2011-2012.

VI. Dispozitat e vendimit nr.414, datë 12.11.1991 të Këshillit të Ministrave, ku përcaktohet krijimi i Akademisë së Arteve, shfuqizohen.

VII. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Financave dhe Universiteti i Arteve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha